



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 629/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 - 30 shtator 2021:

- Gjuhë Shqipe, BA, 240 ECTS, (maksimum 60 studentë për vit akademik);
- Gjuhë Shqipe, MA, 60 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Letërsi Shqipe, BA, 240 ECTS, (maksimum 120 studentë për vit akademik);
- Letërsi Shqipe, MA, 60 ECTS, (maksimum 40 studentë për vit akademik);
- Gjuhësi, PhD, 180 ECTS, (maksimum 10 studentë për vit akademik);
- Letërsi, PhD, 180 ECTS, (maksimum 15 studentë për vit akademik).

II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Filologjik për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 - 30 shtator 2019:

- Orientalistikë, BA, 240 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Gjuhë dhe Letërsi Turke, BA, 240 ECTS, (maksimum 45 studentë për vit akademik);
- Gazetari dhe shkencat e komunikimit, PhD, 180 ECTS, (maksimum 3 studentë për vit akademik);
- Gjuhë dhe Letërsi Frënge, BA, 240 ECTS, (maksimum 60 studentë për vit akademik);
- Gjuhë dhe Letërsi Frënge, MA, 120 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);

- Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS, (maksimum 130 studentë për vit akademik);
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze, MA, 120 ECTS, (me specializime: Gjuhësi; Letërsi), (maksimum 40 studentë për vit akademik).

III. Nuk riakreditoohen programet e studimit:

- Ballkanistikë, BA, 240 ECTS;
- Përkthim dhe Interpretim Profesional, MA, 120 ECTS.

IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

V. Obligohet Fakultetit Filologjik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet Fakulteti Filologjik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

Fakulteti Filologjik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Gjuhë Shqipe	BA	240	Flutura Çitaku, Haki Hysenaj, Ag Apolloni
2	Gjuhë Shqipe	MA	60	Bardh Rugova, Rrahman Paçarizi, Teuta Abrashi
3	Letërsi Shqipe	BA	240	Nysret Krasniqi, Qibrije Demiri - Frangu, Anton Berishaj
4	Letërsi Shqipe	MA	60	Osman Gashi, Kujtim Shala, Rexhep Shala

5	Gjuhësi	PhD	180	Sedat Kuçi, Lindita Rugova, Shkumbin Munish
6	Letërsi	PhD	180	Zejnullah Rrahmani, Sali Bashota, Basri Çapriqi
7	Orientalistikë	BA	240	Isa Memishi, Abdulla Hamiti, Suzana Canhasi
8	Gjuhë dhe Letërsi Turke	BA	240	Irfan Morina, Ergin Jable, Nuran Muhaxheri
9	Gazetari dhe shkencat e komunikimit	PhD	180	Milazim Krasniqi, Shahadete Limani-Beqa, Remzie Shahini-Hoxhaj
10	Gjuhë dhe Letërsi Frënge	BA	240	Valbona Gashi - Berisha, Fehmi Ismajli, Nerimane Kamberi
11	Gjuhë dhe Letërsi Frënge	MA	120	Bade Bajrami, Mehdi Halimi, Avdi Visoka
12	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	BA	240	Lirak Karjagdiu, Bekim Bejta, Sazana Çapriqi
13	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	MA	120	Shykrane Gërmizaj, Muhamet Hamiti, Lindita Tahiri
14	Ballkanistikë	BA	240	/////
15	Përkthim dhe interpretim profesional	MA	120	/////

AKA ka organizuar dy vizita në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Vizita e parë është realizuar me 17.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Dhurata Shehri, Prof. Dr. Thomas Bauer, Prof. Dr. Andrew Goodspeed, Prof. Dr. Persida Asllani. Vizita e dytë është realizuar me 10.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Vjerran Kursar, Prof. Dr. Barbara Kerovac, dhe Prof. Dr. Nelly Labere.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Përkthim dhe Interpretim Profesional, MA, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, Departamenti është i orientuar drejt tregut dhe se ka mangësi për sa i përket organizimit të programit të studimit. Sipas ekspertëve, lëndët e ofruara nga ky program i studimit nuk mbulojnë mjaftueshëm nga staf akademik kompetent përveç

nëse merret staf shtesë nga fakultet e tjera apo jashtë universitetit. Po ashtu ekspertët kanë thënë se departamenti duhet të investojë më tepër në rritjen e nivelit të kualifikimeve të stafit akademik posaçërisht për metodologjinë e mësimdhënies dhe hulumtimit, si dhe teknologjisë. Ekspertët kanë mësuar se Departamenti nuk bën hulumtime fare si dhe nuk është aktiv në bashkëpunim akademik ndërkombëtarë. Sipas ekspertëve, nëse ky departament dëshiron që të jetë departament plotësisht akademik, atëherë menaxhmenti i Universitetit duhet të investojë më tepër burime se sa që bën aktualisht. Përndryshe, ekspertët kanë thënë se do të ishte më mirë nëse departamenti deklarohet si një qendër e Universitetit cila ofron vetëm shërbime të përkthimit si dhe trajnime për përkthim dhe interpretim.

Në lidhje me programin e studimit Ballkanistikë, BA, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit rekomandon dhënien e akreditimit për këtë program, mirëpo duke pasur parasysh se Fakulteti Filologjik nuk ka asnjë doktor shkence, përkatësisht nuk ka 3 PhD me orar të plotë për këtë program në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, KSHC ka marr vendim negativ për akreditimin e programit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë